

Republika e Shqipërisë
Gjykata Administrative e Shkalles se Pare
Korçe

Nr 585 rregjistri themeltar
Date 18.05.2016 regjistrimi.

Nr 1167-(455) vendimi
Date 13.10.2016

VENDIM

"Per nxjerrjen e ceshtjes jashte juridiksionit gjyqesor"

Gjykata Administrative e shkalles se pare Korçe, me trup gjykues te perbere prej:

Gjyqtare e vetme:ETLEVA GJAMO

asistuar prej sekretare gjyqesore Safjola Sadik , ne Gjykatën Administrative te shkalles se pare Korçe, ne daten 13.10.2016 ora 09 45 mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me dyer te hapura ceshtjen administrative me nr 585-00755 rregjistri themeltar, date 18.05.2016 rregjistrimi qe i perket paleve:

PADITES: Shoqeria "Gjolla sh.p.k", me seli ne Buçimas Pogradec, me perfaqesues ligjor Almir Gjolla, i perfaqesuar me prokure te posaçme nga Ruzhdi Shkullaku.

E PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe , perfaqesuar me autorizim nga juriste Mirela Veriga dhe Av e Shtetit Zyra Vendore Korçe, Eva Saraçi.

Objekti: Anullim dhe shfuqizim i "Njoftim vleresim tatimor" te nxjere nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe nr 20 155 date 17.12.2015 mare ne daten 22.12.2015, i cili permban gjobe per mosdeklarim punonjesi 500 000 leke.

Baza Ligjore: Ligji 49/2012, nenet 7/b, 11/1,15/a,17/1,18.4 , Kodi i Procedurave Administrative , neni 18/b, 123, ligji 9920 date 19.05.2008 neni 38.1, 38.2, 106 dhe 107.

Ne seancen gjyqesore te zhvilluar ne prani te paditesit dhe perfaqesuesit te tij dhe ne prani te perfaqesueses se pales se paditur dhe Av se shtetit , gjykata pasi shqyrtoi kerkesen e perfaqesueses se pales se paditur dhe av se shtetit qe kerkuan nxjerrjen e ceshtjes jashte juridiksionit gjyqësor por edhe kryesisht pasi degjoi perfaqesuesin e paditesit qe kerkoi mospranimin e kerkeses dhe shqyrtimin e padise ne themel, pasi shqyrtoi aktet ne teresi

VEREN

Nga aktet bashkangjitur padise e referuar te dhenave te "Ekstraktit te regjistrit tregetar" rezulton se pala paditese eshte regjistruar si "person juridik " me NIPT K03915610A me objekt te veprimtarise "Prodhim dhe tregetim i materialeve te ndryshme te ndertimit, industriale dhe ushqimore, fruta perime, me shumice e pakice e tj", me perfaqesues ligjor Almir Gjolla

Ne datën 17.08.2015 nga Inspektoret e Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçe është mbajtur "Akt konstatimi" sipas të cilit referuar "Aktkonstatimit datë 04.07.2015" të mbajtur nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane, drejtuesi i mjetit kamion me targë PG 5668 B shtetasi Fatos Hamza nuk figuron në listpagesën e muajit Korik 2015 të subjektit "Gjolla sh.p.k", periudhë që perkon me mbajtjen e aktit të konstatimit, ndërsa personi i dytë Anastas Ioka figuron në listpagesën e subjektit "Kreta sh.p.k"

Akti i konstatimit është refuzuar të nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë Almir Gjolla dhe mandej, mbi bazën e të dhënave të "Aktit të konstatimit" me procesverbalin datë 17.08.2015 është vendosur denimi i tatimpaguesit me gjobe në shumën 500 000 leke, bazuar në nenin 119, pikë 1, germa a) të ligjit nr 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe në datën 15.12.2015 ka nxjerrë "Njoftim vleresimin për detyrimet tatimore" , për pagesën e gjobes në shumën 500 000 leke, e cila i është njoftuar subjektit me shkresën nr 20 155 prot datë 17.12.2015.

Meqenëse shoqëria nuk ka qenë dakord me gjobën e vendosur, e ka ankimuar "Njoftim-vleresimin" në Drejtorinë e Apelit Tatimor Tirane, e cila me vendim nr 1805/3 prot datë 14.04.2016, ka refuzuar shqyrtimin e ankimit me arsyetimin se ankimi është paraqitur jashtë afatit 30 ditë nga data kur njoftim vleresimi konsiderohet të jetë marrë nga tatimpaguesi.

Pas rrezimit të ankimit, në datën 17.05.2016 paditesi i është drejtuar Gjykatës me kerkese padi, me anën e të ciles kërkon "Anullim dhe shfuqizim i "Njoftim vleresim tatimor" të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe nr 20 155 datë 17.12.2015 marrë në datën 22.12.2015, i cili përmban gjobe për mosdeklarim punonjësi 500 000 leke.

Në kerkese padi paditesi pretendon se "Njoftim vleresimi për detyrimet tatimore" është marrë në kundërshtim me ligjin pasi shoferi "Fatos Hamza" në bazë të të dhënave të sistemit kompjuterik si dhe pagesave të kryera ka filluar punë në datën 01.07.2015 dhe për të janë paguar sigurime shoqërore deri në datën 03.09.2015 dhe në kushtet e një pasktesie në deklaram, mund të aplikohet një gjobe në masën 10 000 leke. Zbatimi i ligjit nr 99/2015 dhe Udhezimit të Ministrit të Financave nr 31/2015 në momentin e daljes së njoftim vleresimit ka qenë i pezulluar dhe me vendim të Gjykatës Kushtetuese në datën 03.03.2016 janë shfuqizuar nenet 5, 14, 15, 16/4, 17/1, 17/2, 18/2 dhe 20 të ligjit 99/2015, pra është shfuqizuar neni 119 i ligjit 9920 datë 19.05.2008 që përmbante denimin me gjobe në masën 500 000 leke. Në këto kushte denimi i paditesit është bërë në kundërshtim me ligjin dhe njoftim vleresimi duhet të anulohet.

Përfaqësuesja e palës së paditur në prapësimet me shkrim dhe gjatë gjykimit ngriti pretendimin se "Njoftim vleresimi për detyrimin gjobe në shumën 500 000 leke" ka dalë pas verifikimeve të metejshme të DRT Korçe për gjendjen e konstatuar me aktin e konstatimit të DRT Tirane për faktin se mjeti i paditesit drejtohej nga shtetasi Fatos Hamza. Pas konstatimit se ky shtetas nuk ishte deklaruar në skemën e sigurimeve shoqërore por është deklaruar online nga shoqëria vetëm në datën 18.08.2015 me datë fillimi datën 01.07.2015, është mbajtur akti i konstatimit dhe është vendosur denimi me gjobe në shumën 500 000 leke. Pala paditese kërkon anulimin e njoftim vleresimit por nuk identifikon dispozitën që sipas tij është shkelur nga administrata tatimore, ndërkohë që shkelja e ligjit është zbuluar në bazë të kontrollit në

teren, ne zbatim te nenit 80 te ligjit 9920 date 19.05.2008 per identifikimin e personave te paregjistruar.

Ne seancen e pare gjyqesore gjykata ne kuader te verifikimit te juridiksionit gjyqesor per gjykimin e mosmareveshjes, mori ne shqyrtim pretendimin e paditesit se jo per faj te subjektit ankimi administrativ nuk eshte mare ne shqyrtim nga administrata tatimore, duke i lene kohe per te paraqitur "zarfin postar" me te cilin eshte derguar Njoftim vleresimi ne adrese te subjektit, ne kushtet kur ai pretendon se zyrtarisht ka mare dijeni per njoftim vleresimin ne daten 22.12.2015 nepermjet sherbimit postar dhe e ka depozituar ankimin ne poste ne daten 19.01.2015, pra sipas tij brenda afatit 30 ditor.

Gjithashtu nisur nga pretendimi i pales se paditur se Njoftim vleresimi eshte tehequr dorazi prane DRT Korçe nga përfaqësuesi i subjektit ne daten 17.12.2015 , u kerkua paraqitja si prove e regjistrit te dorezimit te akteve.

Ne seancen gjyqesore te dates 13.10.2015 perfaqesuesi i pales paditese ngriti pretendimin se shoqeria nuk e disponon zarfin postar te dergimit te njoftim vleresimit ndersa perfaqesuesja e pales se paditur depozitoi regjistrin e dergimit te akteve , ku pasqyrohet Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore drejtuar subjektit "Gjolla sh.p.k", me perfaqesues Almir Gjolla i cili eshte nisur ne daten 17.12.2015 dhe eshte terhequr dorazi ne kete date me nënshkrimin e perfaqesuesit te shoqerise qe e ka terhequr prane DRT Korçe.

Nisur nga kjo gjendje e dokumentacioni perfaqesuesja e pales se paditur dhe av e Shtetit Zyra Vendore Korçe kerkuan nxjerrjen e çështjes jashte juridiksionit gjyqesor.

Perfaqesuesi i pales paditese kerkoi mospranimin e kerkeses dhe gjykimin ne themel te padise me arsyetimin se pavaresisht faktit se shoqeria nuk e disponon zarfin postar , nuk ka nje akt te hartuar nga DRT Korçe ku te pasqyrohet fakti se njoftimi eshte terhequr dorazi, emrin e personit, dokumentin e identifikimit si dhe autorizimin e administratorit te shoqerise.Referuar permbytjes se vendimit te Drejtorise se Apelimt tatimor ankimi eshte protokolluar ne daten 20.01.2016 pra duke analizuar levisjet postare ankimi eshte dorezuar brenda 32 diteve .Sipas nenit 23 te ligjit 9920 date 19.05.2009 njoftimi vleresohet te jete mare brenda 10 diteve nga data e dergimit ndersa sipas nenit 59 te Kodit te Procedurave Administrative aktet administrative njoftohen brenda 8 diteve.Menyrja e njoftimit dorazi ne rastin konkret pa asnje procedure te rregullt ka kompromentuar dhe ka cenuar interesat e shoqerise pasi i eshte mohuar e drejta e shqyrtimit te apelimit.

Gjykata pasi degjoi pretendimet dhe prapesimet e paleve pa i hyre shqyrtimit ne themel te padise, vlereson se nuk eshte ezauruar ankimi administrativ konform percaktimeve ligjore e persa me siper çështja nuk i perket juridiksionit gjyqesor.

Ne rastin konkret gjykata ndodhet para faktit se Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe ka nxjere "Njoftim vleresimin per detyrimet tatimore " duke i kerkuar paditesit te paguaje detyrimet tatimore ne shumen 500 000 leke gjobe per "Mosdeklarim punonjesi" konform nenit 119/1 te ligjit 9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" dhe Drejtoria e Apelimt Tatimor ka refuzuar ankimin pasi e ka vleresuar te paraqitur jashte afatit 30 ditor te parashikuar nga neni 106.3 i ligjit nga dita qe njoftim vleresimi eshte mare ose vleresohet te jete mare nga tatimpaguesi.

Ndodhur ne kushtet e nje procedure te pafavorshme administrative, tatimpaguesi paraqet padine e tij ne gjykate.

Ne kuptim te nenit 17/a te ligjit 49/2012 qe ben fjale per padine me te cilin kerkohet shfuqizimi ose ndryshimi i nje akti administrativ, sanksionohet e drejta e nje subjekti, ne rastin tone tatimpagues ,per te kerkuar mbrojtjen e te drejtave te tij ne rastet kur pretendon dhe verteton se ato jane cenuar nga akti administrativ apo nga veprimtaria e administrates shteterore.

Ne kete aspekt Gjykata çmon me vend te evidentoje edhe nje rrethane tjeter qe ka te beje me kufijte e kontrollit gjyqesor te akteve administrative si dhe me kushtet qe duhet te plotesohen me qellim qe gjykata te jape nje vendim per zgjidhjen e çeshtjes ne themel.

Referuar sa me siper, Gjykata arsyeton se nese paditesi, do te pretendonte pavlefshmerine absolute te aktit sipas nenit 17.c te ligjit 49/2012 (*pavaresisht cilitimi ose jo te dispozites*), gjykata do te mund te jepte vendim per themelin e pretendimeve te paditesit, pasi kerkimi per pavlefshmeri absolute te aktit nuk kushtezohet nga konsumimi paraprak i rekursit administrativ dhe eshte i pakushtezuar nga ndonje afat parashkrimi, qendrim qe ka mbajtur gjykata e Larte edhe ne vendimin Unifikues nr 3, date 12.02.2008 kur shprehet se :

...nese pretendohet pavlefshmeria absolute e akteve, kerkim qe nuk eshte i ndervaruar nga ndonje afat parashkrimi, gjykata nuk mund ta nxjere ceshtjen jashte juridiksionit gjyqesor, por ne zbatim te nenit 121 te Kodit te Procedurave Administrative dhe 331 te Kodit te Procedurave Civile konstaton pavlefshmerine per efekt te pasojave juridike qe jane krijuar nga akti.

Ne rastin konkret paditesi pretendon shfuqizim te aktit , pra pavlefshmeri relative te tij, gje qe perfundimisht e detyron gjykatën jo vetem mbi kerkesen e pales se paditur por edhe kryesisht te mare ne analize nese jane kushtet ligjore per te patur juridiksionin ne gjykimin e padise se paditesit per pavlefshmerine relative te aktit administrativ.

Po ti referohemi ligjit nr 9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Rpeubliken e Shqiperise", i ndryshuar ne nenin 106 te tij prashikohet e drejta e tatimpaguesit per te ankimuar kunder çdo njoftim vleresimi, çdo vendimi qe ndikon ne detyrimin tatimor, çdo kerkese per rimbursim ose lehtesim tatimor ose çdo akti ekzekutiv te posaçem, ne lidhje me tatimpaguesin " dhe ne piken 3 te ketij neni parashikohet se:

Tatimpaguesi e dorezon ankimin ne Drejtorine e Apelimit Tatimor brenda 30 diteve kalendarike nga data kur njoftim -vleresimi ose vendimi i administrates tatimore eshte mare ose vleresohet te jete mare nga tatimpaguesi .Afati shtyhet ne ditën pasardhese te punes neqoftese dita e fundit bie dite pushimi apo feste zyrtare.

Ne kete aspekt ushtrimi i te drejtes se tatimpaguesit eshte i lidhur me permbushjen nga ana e tij edhe te detyrimeve te tjera ligjore si parakushte per marjen ne shqyrtim te ankimit ne rruge administrative dhe mandej ne rast te nje vendimarrje te pafavorshme, ushtrimin e te drejtes per depozitim te padise ne gjykate.

Ne rastin konkret, paditesi ndonese ka paraqitur ankim ne Drejtorine Apelimit Tatimor per shfuqizimin e njoftim vleresimit te detyrimeve tatimore nuk rezulton te kete permbushur njerin nga kushtet per marjen ne shqyrtim te ankimit administrativ, pra afatin 30

ditor te depozitimit te ankimit nga data ku njoftim vlerësimi eshte mare ose vleresohet te jete mare nga tatimpaguesi.

Po ti referohemi njoftim vleresimit per detyrimet tatimore eshte percaktuar ne menyre te shprehur e drejta e ankimit, afati i ankimit, struktura ku paraqitet ankimi dhe po keshtu edhe ne Udhëzimin nr 24 date 02.09.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar parashikohen rregullat ligjore per proceduren e ankimit dhe kushtet qe duhet te plotesohen per tu pranuar ankimi.

Ne rastin konkret paditesi ka pretenduar se ka mare dijeni per njoftim vleresimin ne ruge postare ne daten 22.12.2015 por as mbi kerkesen e Drejtorise se Apelimt Tatimor dhe as mbi kerkesen e Gjykates nuk vuri ne dispozicion nje akt qe te pretendonte se ka mare dijeni ne kete date. Nderkohe sipas Librit te protokollit te DRT Korçe i cili eshte administruar edhe ne Drejtorine Apelimt Tatimor rezulton qe subjekti ka terhequr dorazi njoftim vleresimin ne daten 17.12.2015 dhe lidhur me kete rethane fakti paditesi pavaresisht pretendimeve se mungon emri i personit, numri i identifikimit dhe autorizimi nga shoqëria, nuk ngriti asnje pretendim per nenshtkrimin e perosnit qe ka terhequr dorazi, nderkohe qe ne te dhenat e librit te protokollit per subjektin "Gjolla sh.p.k" eshte shenuar Almir Gjolla i cili eshte perfaqesuesi i shoqerise. Per me tepër qe paditësi e ka paraqitur ankimin administrativ, pra akti ka qene i njoftuar dhe ne kushtet kur megjithë detyrimin ligjor nuk provon date tjeter njoftimi, vleresohet se njoftim vlerësimi eshte mare ne daten 17.12.2015, ndersa ankimi ne poste eshte dorezuar ne daten 19.01.2016, pra jashte afatit 30 ditor i cili perfundonte ne daten 18.01.2016, meqenese data 16 dhe 17.01.2016 kane qene dite pushimi(fundjave).

Ne referim nenit 106.3.4 te Udhëzimit nr 24 date 02.09.2008 "Nese ankimi prane Drejtorise se Apelimt tatimor nuk behet brenda afatit te caktuar ai konsiderohet i paprueshem"

Ne analize te sa me siper e ne veshtrim te Vendimit Unifikues te Gjykates se Larte nr 3, date 12.02.2008 nuk provohet qe mosshqyrtimi ne themel i ankimit te kete ndodhur per veprime te fajshme te administrates tatimore, por ka ndodhur per veprime te vete subjektit, i cili megjithese ka mare dijeni per njoftim vleresimin tatimor i cili eshte terhequr dorazi nga perfaqesuesi i subjektit, nuk ka vepruar ne permbushje te detyrimeve ligjore.

Persa kohe vertetohet kjo forme njoftimi dhe persa kohe qe paditesi nuk verteton se ka mare dijeni ne nje date tjeter, ankimi administrativ nuk vleresohet i shteruar ne kuptim te ligjit.

Ne veshtrim te nenit 16 te ligjit 49/2012 parashikohet shprehimisht se :

"1. Padia ndaj veprimit administrativ mund të ngrihet vetëm pas shterimit të ankimit administrativ.

Fakti nese çeshtja ben pjese ose jo ne juridiksionin gjyqesor konstatohet ne çdo gjendje dhe shkalle te procedimit dhe njeherazi mungesa e juridiksionit, perben parakusht procedural qe pengon shqyrtimin e themelit te padise dhe nuk perben te mete te padise ne kuptimin procedural qe te mund te ndreqet gjate gjykimit.

Ne analize te sa me siper çmohet se paditesi nuk ka plotesuar kushtet ligjore per tju drejtuar gjykates, parandaj ne veshtrim te nenit 9 te ligjit 49/2012 çeshtja me objekt shfuqizim akti administrativ, ne kete faze te gjykimit duhet te nxiret jashte juridiksionit gjyqesor.

Lidhur me shpenzimet gjyqesore te takses mbi aktet ne shumen 3 000 leke, mbeten ne ngarkim te paditesit meqenese cmohet nxjerja e çeshtjes jashte juridiksionit gjyqesor.

PER KETO ARSYE

Bazuar ne nenin 9 dhe 39 e vijues te ligjit 49/2012

VENDOSA


Nxjerjen jashtë juridiksionit gjyqësor te çeshtjes me paditës "Shoqeria "Gjolla" sh.p.k. pale e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe, me objekt "Anullim dhe shfuqizim i Njoftim vleresimit te nxjere nga DRT Korçe nr 20 155 date 17.12.2015 , i cili përmban gjobe per mosdeklarim punonjësi ne masën 5000 000 leke".

Shpenzimet gjyqesore ne shumen 3 000 leke mbeten ne ngarkim te paditësit.

Kunder vendimit lejohet ankim i veçante ne Kolegjin Administrativ te Gjykates se Larte brenda 5 diteve nga e nesërmyja e shpalljes.

Ushpall ne Korçe date 13.10.2016

**Sekretare
Safjola Sadik**



**GJYQTARE
ETLEVA GJAMO**

